



BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVËS

BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

33 Garibaldi Street Prishtina Kosovo UNMIK

Phone: +381 38 222 055 Fax: +381 38 243 763 Web: www.bpk-kos.org

Në përputhje me pushtetin dhe autoritetin akorduar nga Neni 5, 6 dhe 51 i **Rregullores së UNMIK Nr. 2001/24** Mbi Ndryshimin e **Rregullores së UNMIK Nr. 1999/20** mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, **Rregullores së UNMIK Nr. 1999/4** Mbi Monedhën e Lejuar për përdorim në Kosovë, **Direktivës Administrative së UNMIK Nr. 2001/24** mbi Ndryshimin e **Direktivës Administrative së UNMIK Nr. 1999/2**, Zbatimin e **Rregullores së UNMIK Nr. 1999/4** mbi Monedhën e Lejuar për përdorim në Kosovë, dhe në përputhje me Rregullin e Këshillit të BE-s (KE) Nr. 1338/2001 të datës 28 Qershor 2001 mbi vendosjen e masave për mbrojtjen e euros kundër falsifikimit, si edhe në përputhje me orientimet e Bordit Drejtues së BPK-s miratuar në takimin e tij të datës 20 maj 2004 dhe rikonfirmuar në takimin e tij të date 26 janar 2005.

Nëpërmjet kësaj BPK lëshon si vijon:

Udhëzim Nr. 4

Për Paketimin e Kartmonedhave dhe Monedhave Euro për Depozitimin e Sasisë në BPK

Neni 1

Synimi

Ky Udhëzim u adresohet të gjitha institucioneve financiare që veprojnë në Kosovë, dhe që janë të liçensuara nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK).

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi është saktësimi i standarteve për paketimin dhe emërtimin e njësive për depozitimin e sasive të kartmonedhave dhe monedhave euro në BPK, dhe ka për qëllim rritjen e efektshmërisë së operacioneve të parave “kesh” në të dyja, BPK dhe institucionet financiare, gjithashtu.

Neni 3

Përvijime të Veçanta të Depozitimit të Sasive në BPK

Njësitë e kartmonedhave dhe monedhave euro që do të depozitohen nga institucionet financiare – klientët në Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, duhet të paketohen dhe emërtohen siç specifikohet në këtë Udhëzim:

3.1. Paketimi i Kartmonedhave

Një paketim kartmonedhash do të përmbajë një numër total prej 100 kartmonedhash të së njëjtit emërtim të një serie të kartmonedhave euro.

Do të lidhet me një shirit i cili do të tregojë si vijon:

- Shumën totale në Euro të kartmonedhave që përmban;
- Emrin e institucionit depozitues;
- Të paktën një firmë të stafit i cili ka përpunuar paketimin; dhe
- Datën kur u bë paketimi.

3.2. Gjysmë-pakoja e kartmonedhave

- Një gjysmë-pako do të përmbajë pesë paketime të të njëjtit emërtim të një serie të kartmonedhave euro. Çdo paketim do të jetë në përputhje me specifikimet e përcaktuara sipas (3.1.)
- Pesë paketimet do të lidhen së bashku duke përdorur një rrip ose një qese plastike transparente.

3.3. Pakoja e kartmonedhave

- Një pako do të përmbajë 10 paketa të të njëjtit emërtim të një serie të kartmonedhave euro. Çdo paketim do të jetë në përputhje me specifikimet e përcaktuara sipas (3.1.);
- Dhjetë paketimet do të lidhen së bashku duke përdorur një rrip ose një qese plastike transparente.

3.4. Kërkesa për paketimet e vetme të kartmonedhave për emërtim

Në çdo depozitim lejohen jo më shumë sesa katër paketime të vetme të kartmonedhave për emërtim. Për kartmonedhat euro 500 dhe 200, paketimet e vogla gjithashtu mund të përmbajnë 20 kartmonedha për paketim (paketim i vogël).

Neni 4

Detyrimet dhe Sanksionet

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës ka të drejtën e përmirësimit të mëtejshëm të këtyre standarteve në bashkëpunim me Bankën Qëndrore Evropiane ose Bankat Qëndrore Kombëtare të Sistemit-Euro.

Në rast mospërputhjeje të vazhdueshme me këtë udhëzim, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës ka të drejtën e përgjashtimit të bankave individuale për një kohë të caktuar nga depozitimet në procedurat e depozitimeve me shumicë.

Neni 5

Hyrja në Fuqi

Ky Udhëzim do të hyjë në fuqi në datën 20 mars 2005.